# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-403433**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | EMRI/ Kapet hajduti serial në Shkodër, bashkëpunoi me një të mitur, në banesë iu gjet drogë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/emri-kapet-hajduti-serial-ne-shkoder-bashkepunoi-me-nje-te-mitur-ne-banese-iu-gjet-droge/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 14:34:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 6 shtator 2026, 09:50:59 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0b58e7e2fe6a75f706389a65fc20b41bc4f187922cdea303ce93547af3f54480` |
| TEKSTI | `be47ff970e3a4d00e2e305e287f855650631262fe4f63aba896d10aae78df867` |
| PAMJA | `adc5140931472951d229f0f94d112f3753ba08367ef1019236cfbd3cb14513bb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c333643e15cf6197aa705dbe88c1b7049b2702c358f6caccd2227f10c09ca5f1` |
| E MËPARSHMJA | `66c46504728c7cce0b7be2629dd56801cc0e094be1eb72bde0542ecfa4b710ee` |
| RRËNJA MERKLE | `20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c333643e15cf6197aa705dbe88c1b7049b2702c358f6caccd2227f10c09ca5f1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Një 20-vjeçar i identifikuar si Xhuljan Rrethaj është arrestuar nga policia në Shkodër, pasi dyshohet se ka kryer disa vjedhje në bashkëpunim me një të mitur.

Sipas Policisë, të dyshuarit kanë vjedhur në raste të ndryshme motomjete, një biçikletë elektrike, një celular dhe një shumë parash në një lokal, në Shkodër dhe Velipojë. Gjatë operacionit të koduar "Recently", policia ka sekuestruar dy motomjete të dyshuara të vjedhura, të cilat dyshohet se janë përdorur në aktivitetin kriminal.

Ndërkohë, gjatë kontrollit në banesën e 20-vjeçarit u gjet edhe një sasi e dyshuar lënde narkotike Cannabis sativa. Hetimet vijojnë për të zbardhur raste të tjera vjedhjeje, ku mund të jetë përfshirë i arrestuari.

**Njoftimi i policisë:**

*Shërbimet e Komisariatit të Policisë Shkodër, si rezultat i veprimeve hetimore për zbardhjen e rasteve të vjedhjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve, finalizuan operacionin policor të koduar "Recently", gjatë të cilit u kap dhe u vu në pranga shtetasi:*

*Xh. Rr., 20 vjeç, banues në fshatin Grudë e Re, Shkodër.*

*Nga veprimet hetimore dyshohet se 20-vjeçari, në bashkëpunim me një shtetas të mitur, në periudha të ndryshme, në qytetin e Shkodrës dhe në Velipojë, ka kryer disa raste vjedhjeje, konkretisht motomjete, një biçikletë elektrike, një celular dhe një shumë parash në një lokal.*

5 Gjykata e Lartë le në burg Erion Veliajn

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

*Motomjetet janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale.*

*Gjatë kontrollit në banesën e 20-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një sasi lënde të dyshuar narkotike Cannabis sativa.*

*Vijojnë hetimet për zbardhjen e vjedhjeve të tjera që mund të ketë kryer i arrestuari.*

*Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.*

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



KRONIKË

**Pagat e magjistratëve/ Komisioni i Ligjeve...**

Xhuljana Zhuleku · 19 minuta më parë



KRONIKË

**Përplasen makinat në Dibër, lëndohen 5...**

Xhuljana Zhuleku · 34 minuta më parë




KRONIKË

**Gjirokastër/ Zjarri përhapet pranë...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv   Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.